



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.6.2023

Nr: 645

Ora: 09:30

VENDIM  
PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË, QARKU LEZHË Z. PJERIN ZEF NDREU, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 2.6.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, Qarku Lezhë, z. Pjerin Zef Ndreu, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Data: 2.6.2023 Nr: 645  
Ora: 09:30



"Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë Qarku Lezhë, z. Pjerin Zef Ndreu, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

Bazuar në nenin 19, shkronja “i”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 545, datë 23.05.2023, ka shpallur fitues z. Pjerin Zef Ndreu, si Kryetar i Bashkisë Lezhë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### **VENDOS:**

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, Qarku Lezhë, z. Pjerin Zef Ndreu, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**